



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .01.2022

**MBLEDHJA Nr. 01,
datë 13.01.2022, ora 12:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 13.01.2022, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 01 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi licencimin e shoqërisë “Breçani R.O.S.P” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Drita” me kapacitet të instaluar 1980 kW
2. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 196, datë 22.09.2021, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të saj”
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “Age Kuç” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Kuç” me kapacitet të instaluar 1930 kW
4. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Blue 1” me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW
5. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik i digës Qyrsaq, Hec Vau i Dejës, me kapacitet të instaluar 5.143 MWp
6. Mbi kërkesën e shoqërisë E.T.H–H sh.p.k. për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës nr. 205, seria PV12K, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., për rinovimin e licencës nr. 358, seria T17P, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 13, datë 19.01.2017
8. Çështje të tjera

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”; (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; dhe (iv) Urdhërit nr. 19, datë 19.02.2021, “Për ndryshimin e pikës 1, të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, për lejimin e pjesëmarrjes së palëve të treta, nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik, për sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit, si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore teknike apo publike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI